REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
Hajvali - Prishtinë
Nr / Br. 04-052/1299/2
Data / Datum 04.11.2024

REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT
Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë

Referencë: **IPK/31102024/DI**
Datë: **31.10.2024**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit, Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), si dhe Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Trajtimi i dhunës në familje nga Policia e Kosovës
Referenca	- 06/2024
Data e inicimit	- 04.07.2024
Data e raportimit	- 29.10.2024
Arsyet e inicimit	- IPK ka mandat të kryejë inspektime në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështet Policinë për të siguruar shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit për këtë vit ka paraparë kryerjen e një varg inspektimesh në disa fusha të menaxhimit, përfshirë edhe atë të trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Ka disa vite që IPK ndërmerr inspektime në radhët e Policisë për vlerësimin e performancës së strukturave të saj në parandalimin dhe luftimin e këtij krimi që po vazhdon të jetë prezent në shoqërinë kosovare. Këtë vit është vazhduar me vlerësimin e veprimeve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, duke u fokusuar edhe në stacionet që më parë kanë mundur të mos jenë në fokus të IPK-së. Përmes këtij inspektimi, IPK synon që të vlerësoj nëse strukturat përkatëse në kuadër të stacioneve policore po përmbushin mandatin ligjor dhe obligimet që dalin nga Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Ky inspektim ofron një mundësi për t'u njohur me performancën e njësive patrulluese dhe atyre hetimore në trajtimin me sukses të veprave penale të kësaj natyre.
Objektivat e inspektimit	- Vlerësimi i kapaciteteve policore për trajtimin e rasteve, - Vlerësimi i reagimit policor dhe hetimit të rasteve të dhunës në familje, - Vlerësimi i aktiviteteve policore në monitorimin e urdhrave mbrojtës, - Vlerësimi i përmbajtjes së dosjeve dhe evidencave.
Metodologjia e inspektimit	- Takime - intervista me dymbëdhjetë (12) drejtues - bartës të funksioneve: (a) Shefat e Sektorëve të Hetimeve në stacionet policore; - Këqyrje - verifikime: të funksionimit të bazës elektronike të të dhënave mbi procedimin e lëndëve në Prokurorinë e Shtetit, Logut operacional, etj.; - Marrje dokumentesh fizike apo elektronike, si: 23 kopje të dosjeve të rasteve të trajtuara të dhunës në familje (nga 3 sosh për stacionet e kategorisë A, nga 2 sosh për stacionet e kategorisë B dhe nga 1 sosh për ato të kategorisë C).
Subjekti	- Stacionet në Podujevë dhe Lipjan (Drejtoria Rajonale - Prishtinë), - Stacionet në Viti dhe Novo Bërdë (Drejtoria Rajonale - Gjilan), - Stacioni në Deçan (Drejtoria Rajonale - Pejë),

	- Stacioni në Skenderaj (Drejtoria Rajonale-Mitrovicë Jugu), - Stacionet në Dragash dhe Suharekë (Drejtoria Rajonale - Prizren), - Stacionet në Shtime dhe Shtërpcë (Drejtoria Rajonale - Ferizaj), - Stacionet në Mitrovicë Veriu dhe Zveçan (Drejtoria Rajonale - Mitrovicë Veriu)
Afatet e inspektimit	- Fillimi - 09.07.2024; - Përfundimi - 24.07.2024; - Periudha e mbulimit - dy (2) vitet e fundit dhe gjendja aktuale.
Kriteri vlerësues (standardi)	- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, - Kodi i Procedurës Penale, - Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, - Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, - Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, - Rregullore për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, - Rregullore për Operativë në Policinë e Kosovës, - PSO - Koha e reagimit (07 shtator 2018), - PSO - Procedimi i Lëndëve dhe Kompetencat Lëndore të Hetimit, - PSO - Sistemet Informative të Policisë së Kosovës, - PSO - Parandalimi dhe Trajtimi i Dhunës në Familje (08 prill 2022), - PSO - Ekzekutimi i urdhrave mbrojtës (31 janar 2023).
Ekipi realizues	- Fitore Gajraku, inspektore, - Servet Tasholli, inspektor,
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së
Datë	- 31.10.2024

Shkurtesat

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DPBP	Drejtoria për Policinë në Bashkësi dhe Parandalim
DRP	Drejtoria Rajonale Policore
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MV	Mbrojtësi i Viktimave
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedura Standarde e Operimit
QPS	Qendra për Punë Sociale
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

Inspektimi nxjerrë në pah se:

- *Lidhur me burimet njerëzore në kuadër të njësive hetimore të dhunës në familje janë hasur dobësi lidhur mosplotësimin e vendeve të punës në kuadër të njësive hetimore në disa prej stacioneve policore, si dhe mos funksionalizimin e Ekipit të hetimit të dhunës në familje, mos lëshimin e vendimeve për hetuesit konform Strukturës së re të organizimit/LPA-së.*
- *Lidhur me aktivitetet operative dhe hetimore është hasur përmirësim i kohës mesatare së reagimit në thirrjet e qytetarëve për dhunë në familje. Është evidentuar mungesë në disa dosje të raporteve njoftuese për Prokurorin mbi dyshimet e arsyeshme të kryerjes së veprave penale, mos aplikimin e vlerësimit të rrezikut për viktimat në një numër rastesh sipas formës së përcaktuar, cilësinë në disa prej kallëzimeve penale (ana teknike dhe përmbajtësore), mungesën e Raportit ditor për rastin e dhunës në familje në disa prej dosjeve, si dhe mosrespektimin e zinxhirit komandues gjatë procedimit të një numri të konsideruar kallëzimesh penale.*
- *Lidhur me infrastrukturën fizike dhe teknike ka pasur ngecje në krijimin dhe funksionalizimin e "dhomave mike" në disa prej stacioneve policore.*

Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. *IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore të inspektuara, që në koordinim me Drejtoritë Rajonale dhe Drejtorinë e Personelit, të ndërmarrin veprime për të funksionalizuar ekipet e hetimit të dhunës në familje, si dhe të përmbushin të njëjtat me burimet e nevojshme njerëzore konform Strukturës organizative dhe Listës së Personelit të Autorizuar.*
2. *IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore në Novo Bërdë dhe Dragash, shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve, që të mobilizohen në ushtrimin e kontrolleve mbi njësitë policore, për të siguruar kohë efektive të reagimit në thirrje të qytetarëve për dhunë në familje.*
3. *IPK-ja u rekomandon shefave të sektorëve të hetimeve dhe mbikëqyrësve të ekipeve të hetimeve, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit që trajtojnë rastet e dhunës në familje, për t'u siguruar se Mbrojtësit e Viktimave njoftohen edhe me shkrim lidhur me rastet, për të qenë në funksion të viktimave të dhunës në familje.*
4. *IPK-ja u rekomandon shefave të sektorëve të hetimeve në kuadër të stacioneve policore, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit e dhunës në familje, për t'u siguruar që gjatë intervistimit të palëve, u parashtrohet numër më i madh pyetjesh lidhur me rastet dhe që në konsultim me Prokurorin kompetent, intervistat të përfshijnë edhe dëshmitarë tjerë potencial që mund t'i kontribuojnë zbardhjes së rastit.*
5. *IPK-ja u rekomandon shefave të sektorëve të hetimeve të stacioneve (Podujevë, Suharekë dhe Deçan), që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit e dhunës në familje, për t'u siguruar se në të gjitha rastet kur ka dhunë në familje, përpilohet Raport ditor lidhur me rastin dhe një kopje e tij i dërgohet mbikëqyrësit rajonal të dhunës në familje dhe sektorit qendror.*
6. *IPK-ja u rekomandon shefave të sektorëve të hetimeve të stacioneve policore (Lipjan, Novobërdë, Skenderaj, Deçan, Viti, Podujevë, Suharekë, Zveçan, Shtime, Shtërpce dhe Mitrovicë Veriu), që gjatë ushtrimit të kontrollit mbi lëndët, të ndiqet procedura e aprovimit sipas zinxhirit komandues dhe fillimisht ato të aprovohen nga hetuesit e lëndëve, mbikëqyrësi i vijës së parë dhe më pas nga Shefi i Sektorit të Hetimeve, konform Procedurës Standarde të Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit.*

Faktet kyçe

Trendët e krimit	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Trendi në %	+20.1	+24.8	+8	+18.7	+12.5	-4.5%
Numri rasteve	1.534	1.915	2.069	2.456	2.764	2.639

Ekspozimi i dhunës në familje në 1.000 banorë	(2023)
Në nivel vendi (numri i rasteve)	1.49
Më i lartë në Fushë Kosovë (numri i rasteve)	3.57
Më i ulët në Zubin Potok (numri i rasteve)	0.15

Ekspozimi i dhunës në familje në 1 km²	(2023)
Në nivel vendi (numri i rasteve)	0.24
Më i lartë në Mitrovicë Veriu (numri i rasteve)	3.64
Më i ulët në Zubin Potok (numri i rasteve)	0.01

Reagimi policor në rastet e dhunës në familje (në minuta)	(2023)
Mesatarja e reagimit për 12 stacione (në minuta)	18.1
Stacioni me reagimin më të shpejtë (Mitrovicë e Veriut)	5.4
Stacioni me reagimin më të ngathtë (Novo Bërdë)	32.4

Numri i të ndaluarve (për çdo 10 raste)	(2023)
Në nivel të të gjitha DRP-ve	3.9
Më së shumti në DRP - Gjakovë	5.7
Më së paku në DP - Mitrovicë Jugu	2.8

Prezenca e MV-ve (për çdo 10 raste)	(2023)
Në nivel të të gjitha DRP-ve	0.9
Më i lartë në DRP - Prishtinë	2.5
Më i ulët në DRP - Gjilan	0

Prezenca e Zyrtarit të QPS (për çdo 10 raste)	(2023)
Në nivel të të gjitha DRP-ve	3.3
Më i lartë në DRP - Prishtinë	5.8
Më i ulët në DRP - Gjilan	0.3

Gjetjet kryesore:

1. Trendët e dhunës në familje dhe ekspozimi

1.1. Si herëve të tjera, IPK edhe këtë vit ka analizuar trendin e rasteve të raportuara të dhunës në familje dhe krahasuar me vitet e kaluara, në vitin 2023 del se numri i rasteve ka trend rënës. Siç është cekur në raportin e vitit të kaluar, rastet e raportuara të dhunës në familje për shumë vite me radhë kanë pasur trend rritës dhe në përmasa shqetësuese brenda shoqërisë kosovare. Vetëm në periudhën nga viti 2018 deri më 2022, trendi rritës i numrit të rasteve ka arritur në kuotat: +20% (2018), +25% (2019), +8% (2020), +19% (2021) dhe +13% (2022). Të dhënat statistikore të vitit 2023 pasqyrojnë rënie të numrit të rasteve krahasuar me vitin praprak në masën prej -4.5%, duke dhënë sinjal se kjo dukuri po merr trajtimin e duhur nga shoqëria e institucionet që e luftojnë atë.

Diagrami 1 - Trendi i rasteve të dhunës në familje (2018-2023)



1.2. Në vitin 2023, ngritje të numrit të rasteve të dhunës në familje ka pasur në dy zona të përgjegjësive të DRP-ve (Pejë e Prizren), derisa në zonat tjera ka pasur trend rënës të numrit të rasteve të raportuara. Në vitin 2023, rreth 33% e rasteve të raportuara kanë ndodhur në zonën e përgjegjësisë që kontrollon DRP - Prishtinë, duke e bërë këtë si zonë më të ngarkuar me raste të dhunës në familje. Komuna e Prishtinës, territori i së cilës kontrollohet nga tre stacione policore numëron 415 raste të raportuara dhe del të jetë më e ngarkuara me raste të kësaj natyre (15.7%).

Diagrami 2 - Shpërndarja e rasteve sipas zonës së përgjegjësive të DRP-ve (2022-2023)

1.3. Nga një kryqëzim i parametrave të dhunës në familje sa i përket ekspozimit për 1.000 banorë dhe në 1 km², del se kjo vepër është më kërcënues në zonat e përgjegjësisë që kontrollojnë stacionet policore në Mitrovicë Veriu, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe në Shtërpcë. Nëse vështrojmë ekspozimin e këtij krimi për raste të ndodhura në 1.000 banorë, shihet se ekspozimi i tij është po ashtu i dukshëm edhe në zona e përgjegjësisë që kontrollojnë stacionet policore në Obiliq, Pejë, Gjilan, Partesh dhe Kllokot. Nëse e analizojmë trendin e rasteve të dhunës në familje sipas stacioneve dhe krahasojmë vitin 2023 me vitin 2022, del se 24 nga gjithsej 41 stacione policore të rendit kanë shënuar rënie të numrit të rasteve, përderisa 17 të tjera ose kanë regjistruar më shumë raste se në vitin paraprak, ose kanë numër të njëjtë të rasteve të raportuara. Stacionet me ngritje më të theksuar të rasteve të raportuara të dhunës në familje krahasuar me një vit më parë del të jenë: Novo Bërda me +160%, Shtërpca me +66.7%, Obiliqi me +58.6%, Mitrovicë Veriu me +30.3%, Istogu me +30.2%, Prizreni me +12.8%, etj.

Mbi 1.5 raste në 1 km²				Fushë Kosovë Mitrovicë Veriu
1.0 -1.5 raste në 1 km²				
0.5-0.99 raste në 1 km²		Prishtinë		
0-0.49 raste në 1 km²	Dragash Mamushë Kaçanik Shtime Hani i Elezit Rahovec Klinë Deçan Junik Kamenicë Ranillug Zveçan Leposaviq Zubin Potok	Podujevë Lipjan Drenas Prizren Suharekë Ferizaj Mitrovicë Jugu Vushtrri Skenderaj Gjakovë Malishevë Viti Novo Bërdë	Obiliq Pejë Gjilan Partesh Kllokot	Graçanicë Shtërpcë
Ekspozimi	0-0.99 raste në 1.000 banorë	1.0-1.99 raste në 1.000 banorë	2.0-2.99 raste në 1.000 banorë	3.0-3.99 raste në 1.000 banorë

1.4. Femrat vazhdojnë të jenë më të prekurat në numër si viktima të dhunës në familje. Nga numri i përgjithshëm prej 2.717 personash të prekur nga dhuna në familje gjatë vitit 2023, raporti i viktimave sipas gjinisë është 78%:22% (raporti femra-meshkuj). Nisur nga kjo përqindje del se ka një ndryshim të këtij raporti, meqë në vitin 2022, kjo strukturë ka qenë 81.5%:18.5%. Rreth 64% e viktimave në vitin 2023 kanë qenë në marrëdhënie familjare "bashkëshortë", pasuar nga viktimat në marrëdhënie familjare "bashkëjetesë" me 12%, etj. Shkaktarët më të shpeshtë të dhunës në familje janë "marrëdhëniet e çrregulluara brenda familjes" (19%), "xhelozia" (16%), "pushteti që kërkon të vendos njëri nga anëtarët tek tjetri" (13%), etj. Në 47% të rasteve gjatë vitit 2023 është ushtruar "dhunë fizike" ndaj viktimave, në 52% të rasteve është ushtruar "dhunë psiqike", kurse "dhuna ekonomike" përfaqësohet me 1%.

2. Baza ligjore, organizimi dhe kapacitetet

2.1. Konventa e Stambollit[1] e njeh dhunën ndaj grave, duke përfshirë edhe dhunën në familje, si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi. Sipas saj, shtetet kanë përgjegjësi nëse nuk i përgjigjen në mënyrën e duhur kësaj dhune. Nisur nga fakti që mbrojtja nga dhuna në familje është ndër prioritetet e Qeverisë, me qëllim të forcimit të masave për evidentimin, parandalimin dhe trajtimin sa më korrekt të rasteve të dhunës dhe rasteve tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, janë marrë masa për zbatim korrekt të legjislacionit dhe trajtimin me profesionalizëm të rasteve. Janë ndërmarrë iniciativa për përmirësimin e kuadrit ligjor, për një përgjigje të mirë - koordinuar dhe efektive ndaj dhunës në familje, duke nxjerrë edhe ligj të veçantë. Tashmë është në fuqi Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, që adreson kërkesat e Konventës në fjalë. Ligji parasheh masa të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, si dhe garantimin e mbrojtjes së viktimave. Është hartuar edhe Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022 -2026) që ndanë përgjegjësi për një varg akterësh, siç përcaktohet edhe me Konventë, ku bëhet thirrje për përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe shërbimeve përkatëse shtetërore, në një qasje të koordinuar të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Këto dokumente kanë paraparë një rol me rëndësi edhe për Policinë.

[1] Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje u miratua nga Komiteti i Ministrave të KE-së më 07 prill 2011 dhe ka hyrë në fuqi më 01 gusht 2014.

2.2. Ashtu edhe siç e ka paraparë Konventa e Stambollit, dhunën në familje si një nga format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore, dhuna në familje nga viti 2019 është paraparë si vepër penale edhe në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (neni 248). Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore përbëjnë dokumentet bazike, në bazë të të cilave Policia ushtron detyrat e autorizimet e saj në parandalimin dhe luftimin e këtij krimi. Policia ka nxjerrë edhe dokumente tjera, që detajojnë procedurat e veprimit, përfshirë parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje (08.04.2022) dhe ekzekutimin e urdhrave mbrojtës (31.01.2023).

2.3. Sipas nenit 19, paragrafi 9 të Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë vendosin strukturën organizative dhe hierarkinë e organeve në kuadër të policisë për trajtimin e dhunës në familje me kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe financiare. Me qëllim që t'i kushtohet kujdes i duhur trajtimit të rasteve të dhunës në familje, Policia ka paraparë në nivel rajonal dhe në të gjitha kategoritë e stacioneve policore, zyrtarë përgjegjës për këto raste. PSO - Parandalimi dhe Trajtimi i Dhunës në Familje ka paraparë që në çdo rajon të jenë nga katër (4) zyrtarë (njëri nga ta mbikëqyrës) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Në nivel stacionesh, po ashtu ka paraparë staf përgjegjës që të merret me rastet e dhunës në familje. Për stacionet e kategorisë A parashihen nga katër (4) zyrtarë policor hetues, në ato të kategorisë B nga tre (3) zyrtarë policor hetues dhe në ato të kategorisë C nga dy (2) zyrtarë policor hetues. Sipas PSO-së, një zyrtar duhet të jetë i zgjedhur hetues primar i dhunës në familje. IPK-ja ka analizuar Strukturën e re në raport me PSO-në lidhur me organizimin e njësive hetimore, si dhe kapacitetet brenda tyre. Struktura e re[2] tek kategoria A e stacioneve ndanë resurse konform PSO-së[3]. Mirëpo te stacionet e kategorisë B dhe C, Struktura ka paraparë numër më të vogël se numri i zyrtarëve të përcaktuar me PSO. Tek kategoria C e stacioneve, në kuadër të Njësisë së hetimeve me Strukturë në disa stacione nuk parashihet Ekipi i zyrtarëve policor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

2.4. Me qëllim të vlerësimit të organizimit të njësive të hetimit të dhunës në familje në kuadër të stacioneve, IPK ka inspektuar dhe analizuar disa prej tyre, të shpërndara në të tre kategoritë. Gjatë vizitës në stacionet e Podujevës (A), Mitrovicës Veriu (A), Zveçanit (B), Skenderajt (B), Lipjanit (B), Dragashit (B), Deçanit (B), Suharekës (B), Vitisë (B), Shtimes (C), Shtërpcës (C) dhe Novobërdës (C), janë verifikuar kapacitetet sasiore të burimeve njerëzore të ekipeve hetimore, nga ka rezultuar gjendja si vijon:

(a) Në Podujevë (A), në Ekipin për trajtimin e dhunës në familje dhe delikuencës së të miturve janë angazhuar dy (2) zyrtarë nga katër (4) sa janë paraparë, kurse në Mitrovicë Veriu (A), trajtimi i rasteve bëhet nga një (1) zyrtar edhe pse parashihen tre (3) me Strukturë (në të dy këto stacione mungon rreshteri që sipas Strukturës duhet të udhëheqë Ekipin e trajtimit të rasteve të dhunës në familje),

(b) Në stacionet e kategorisë B (Suharekë, Dragash, Viti, Skenderaj, Deçan e Zveçan) Struktura parasheh ekipet për trajtimin e dhunës në familje me nga dy (2) zyrtarë policor, por në dy prej tyre ajo nuk është përmbushur me personel (Dragashi dhe Zveqani kanë nga një zyrtar më pak). Edhe pse Lipjani parashihet të ketë Ekip me një (1) rreshter dhe dy (2) zyrtarë policor, në kohën e inspektimit nuk është gjetur asnjë zyrtar i sistemuar me vendim të punës si pjesë e këtij Ekipi (trajtimi i rasteve të dhunës në familje bëhet nga hetues të ekipeve të tjera të Sektorit të Hetimeve).

(c) Struktura sasiore e personelit tek stacionet e kategorisë C ndryshon. Shtërpca, Novobërda dhe Shtimja kanë Ekip për trajtim të dhunës në familje dhe delikuencës së të miturve. Në Shtime është angazhuar një hetues konform Strukturës për të trajtuar rastet. Edhe pse parashihet që Shtërpca të ketë një zyrtar për hetimin e

[2] E aprovuar me 10.07.2023.

[3] PSO për Parandalimin dhe Trajtimin e Dhunës në Familje, ref. DDO-04-036-2022, datë: 08.04.2022.

rasteve, vendosja e personelit nuk është në harmoni me Strukturën, meqë ka tejkalim të numrit në Ekip për tre (3) zyrtarë. Novo Bërda parashihet të ketë Ekipin me një (1) zyrtar policor, por bazuar në vendimet për vendin e punës, aktualisht Ekipi ka dy zyrtarë policor[4].

2.5. Trajnimi i zyrtarëve policor për trajtim të dhunës në familje është hap me rëndësi në përmirësimin e reagimit policor dhe ndihmës ndaj viktimave të dhunës në familje. Trajnimi ndihmon të kuptohen dhe trajtohen me ndjeshmëri dhe profesionalizëm këto raste. PSO-ja në kapitullin V (Personeli dhe përgjegjësitë, pika h) përcakton që çdo pjesëtar i Policisë që trajton raste të dhunës në familje duhet të jetë i trajnuar, apo të ndjekë trajnimin adekuat profesional të organizuar nga departamenti i trajnimeve apo institucionet dhe organizatat tjera. Pjesa dërmuese e hetuesve të këtyre rasteve kanë kryer trajnime përkatëse dhe janë certifikuar. Stacionet e inspektuara kanë dëshmuar që kanë në mesin e tyre dhe zyrtarë tjerë, që nuk punojnë me raste të dhunës në familje, por kanë kryer trajnimin për të reaguar si reagues të parë në vendin e ngjarjes. IPK-ja ka analizuar ndjekjen e trajnimeve dhe certifikimin e personelit përgjegjës për trajtim të këtyre rasteve. Në stacionet e inspektuara të kategorisë A, B dhe C, gjendja është e kënaqshme meqë gjithë zyrtarët që trajtojnë dhunën në familje kanë trajnime dhe janë të certifikuar.

2.6. Gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje sipas procedurave standarde, stacionet policore duhet që viktimat t'i intervistojnë në hapësira të përshtatshme të cilat ofrojnë komoditet dhe janë më të pranueshme sidomos në rastet kur viktimë janë personat të mitur. Këto hapësira duhet të jenë të pajisura me orendi dhe dekorim të brendshëm në mënyrë që të kryhen intervista në mjedise miqësore dhe të sigurta për viktimat e dhunës në familje. Stacionet policore në Zveçan dhe Novo Bërdë nuk kanë "dhomë mike", hapësirë kjo që do të ofronte një ambient të përshtatshëm për këtë kategori të ndjeshme të viktimave të rasteve të dhunës në familje, ndërsa stacionet e tjera të inspektuara kanë të ndara këto hapësira për të ofruar një ambient komod dhe të pranueshëm për viktimat e dhunës në familje.

3. Performanca policore në trajtimin e dhunës në familje

3.1. Për të vlerësuar respektimin e rregullave dhe të procedurave hetimore, IPK-ja ka kontrolluar njëzet e tre (23) dosje të rasteve të dhunës në familje, që janë proceduar tek Prokurori i Shtetit. Në kuadër të dosjeve është vlerësuar rregullsia e lëndëve, nëse ato përmbajnë veprimet, dokumentet dhe formularët e nevojshëm që kanë të bëjnë me hetimin e dokumentimin e krimit. Është verifikuar respektimi i disa prej veprimeve paraprake hetimore, përdorimi i formularëve standard brenda rasteve dhe regjistrimi i tyre sipas procedurës së regjistrimit të rasteve në regjistra.

3.2. Është e njohur se Policia është e mandatuar të parandaloj, hetoj dhe zbuloj veprat penale, si dhe kryesit e tyre. Policia duhet t'i përgjigjet secilit njoftim për veprat ose kërcënimet e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore ose shkeljes së urdhrit për mbrojtje apo të urdhrit për mbrojtje emergjente pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin[5]. IPK-ja ka matur përsëri kohën e reagimit në thirrjet për dhunë në familje. Koha mesatare e reagimit në zonë urbane llogaritet të jetë maksimum 15 minuta, kurse për zonë rurale maksimum 30 minuta, varësisht prej lokacionit ku ndodhë rasti, me përjashtim eventual në zona të thella malore e kushte të papërshtatshme atmosferike[6]. Nga 257 mostra të 12 stacioneve, që përfaqësojnë rreth ⅒ e rasteve të raportuara të dhunës në familje në nivel vendi, ka rezultuar se nga pranimi i thirrjeve, njësitë e para

[4] Meqë tani është në fuqi Struktura e re organizative, IPK është interesuar të dijë nëse personeli i uniformuar në kuadër të ekipeve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje është pajisur me vendime adekuate. Të dhënat e paraqitura në këtë Raport inspektimi janë bazuar në vendimet për vendin e punës dhe Ekipin ku punojnë.

[5] Neni 19, paragrafi 1 i Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore (Përgjegjësitë e Policisë së Kosovës).

[6] Departamenti për Operacione, *PSO - Koha e reagimit policor,* ref. DDO-04/085/2018, datë 07.09.2018.

	në vendin e ngjarjes kanë arritur mesatarisht për 18.1 minuta, kohë kjo më e shpejtë krahasuar me matjet e herës së kaluar kur IPK ka kryer inspektim në disa stacione[7]. Mostrat, nga të cilat është matur koha e reagimit janë mostra të thirrjeve kur njësitë kanë shkuar në vendin e ngjarjes, duke u përjashtuar mostrat kur raportimet e palëve janë kryer në stacione. Stacionet në Mitrovicë të Veriut, Zveçan dhe Viti kanë arritur kohën më të shpejtë në reagim në thirrje, derisa stacionet me kohën më të ngadaltë (shtyrë) të reagimit janë Novo Bërda dhe Dragashi.  3.3. Ligji përcakton që Policia duhet kujdesur për sigurimin e transportimit të viktimës dhe vartësve të saj deri në objektin e duhur mjekësor për trajtim ose kontroll mjekësor gjatë procedimit të rastit në polici. Njëjtë edhe PSO përcakton që Policia mundëson qasjen e ndihmës së nevojshme mjekësore dhe sigurimin e transportit për viktimën dhe vartësit e saj/tij deri në institucionin shëndetësor. Sipas dosjeve të inspektuara, në rastet kur viktimat kanë deklaruar se kanë nevojë për trajtim mjekësor, u është ofruar trajtim mjekësor dhe për ekzaminimet e kryera janë nxjerrë raporte mjekësore, që janë bashkëngjitur në dosje hetimore. Në vitin 2021 janë realizuar 834 ndihma mjekësore, në vitin 2022 janë realizuar 1.161, kurse në vitin 2023 janë realizuar 1.192 të tilla. Në vitin 2021, rreth 3.4 viktima në çdo 10 sosh kanë përfituar nga ndihma mjekësore, në vitin 2022, rreth 4.1 viktima, kurse në vitin 2023 kjo mesatare është ngritur në 4.4 viktima në çdo 10 sosh. 3.4. Në rastet kur dyshohet se personat e përfshirë në dhunë në familje janë nën ndikim të alkoolit, duhet t'iu bëhet matja e promilëve në gjak përmes alkool testit dhe kjo të evidentohet në raport[8]. Gjatë inspektimit, përgjegjës në sektorët e hetimeve në kuadër të stacioneve kanë paraqitur certifikatat e alkool testeve, duke dëshmuar se të njëjtat janë funksionale dhe shërbejnë për përmbushjen e objektivit. Stacionet e inspektuara janë të pajisura me alkool test dhe të njëjtat janë të funksionale dhe të kalibruara. Pas kontrollit të 23 dosjeve, është vërejtur se në katër (4) raste kur ka pasur dyshime se kryesit e veprave penale kanë qenë nën ndikimin e alkoolit, të njëjtëve iu është matur prezenca e alkoolit në gjak përmes alkool testit, gjë që e dëshmojnë edhe formularët e testimeve të bëra, që janë pjesë e dosjeve[9].

[7] Shih Raportin e inspektimit nr. 08/2023 - Trajtimi i dhunës në familje nga Policia e Kosovës.
[8] Kapitulli VI, pika 4 e Procedurës Standarde të Operimit për Parandalimin dhe Trajtimin e Dhunës në Familje.
[9] 2024-BF-3 (Skenderaj), 2024-CG-095 (Viti), 2024-SG-37 (Zveçan) dhe 2024-CD-36 (Shtërpcë).

3.5. Rastet e dhunës në familje kërkojnë reagim të shpejtë dhe vigjilencë, meqë nga kjo varet mënjanimi/zvogëlimi i pasojave që mund të rrjedhin nga ushtrimi i dhunës eventuale. Sipas nenit 19, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-185, nëse ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer vepra që ka të bëjë me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, Policia e ndalon kryerësin e supozuar në pajtim me ligjin. Në vitin 2021, Policia ka ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orëve, gjithsej 612 persona, në vitin 2022, ky numër ka arritur në 1.084 persona, kurse në vitin 2023, ky numër ka arritur në 1.037 persona. Nga këta tregues rezulton se në vitin 2021, afërsisht 2.5 persona janë ndaluar në çdo 10 raste të raportuara me dyshimin se kanë kryer vepër penale, në vitin 2022, afërsisht 3.9 persona janë ndaluar në çdo 10 raste të raportuara, kurse në vitin 2023, afërsisht 3.9 persona janë ndaluar në çdo 10 raste të raportuara. Krahasuar me vitin 2021, shifrat e dy viteve të fundit tregojnë një rigorozitet në ndalimin e një numri më të madh të kryerësve potencial të veprave të dhunës në familje. Sipas matjeve në nivel rajonal rezulton se në vitin 2023, numri i të ndaluarve në raport me numrin e rasteve është më i lartë në kuadër të DRP - Gjakovë që arrin në 5.7 të ndaluar në çdo 10 raste të raportuara, derisa më i ulët është në kuadër të DRP-Mitrovicë Jugu me 2.8 të ndaluar në çdo 10 raste të raportuara.

3.6. Ligji në fuqi dhe PSO kanë përcaktuar rolet, detyrat dhe përgjegjësitë për akterët institucional, duke përfshirë dhe mbrojtësit e viktimave. Ligji kur përcakton detyrat policore, potencon dhe atë mbi informimin e viktimës, përfaqësuesin ligjor ose mbrojtësin e viktimës për të drejtat e viktimës, në veçanti për të kërkuar urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente[10]. MV-ja është përfaqësues i autorizuar për mbrojtjen e interesave të viktimës dhe realizimin e të drejtave të tij/saj në përputhje me ligjin. Edhe PSO përshkruan rolin e MV-së si person i autorizuar zyrtar, që direkt ndihmon palën e dëmtuar që nga kontaktet e para me organet kompetente të mbrojtjes, që këshillon, inicion procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes, që është i obliguar të marrë pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, të monitorojë mbarëvajtjen e procesit gjyqësor. Sipas PSO-së, është detyrë e hetuesit të dhunës në familje në nivel stacioni që të njoftojë mbrojtësin e viktimave[11]. Sipas DPBP-së, zyrtarët policor gjithnjë njoftojnë MV-të me telefon dhe përmes raporteve ditore në mënyrë elektronike. Në dosjet e kontrolluara dëshmohet që në proces për trajtimin e viktimave janë përfshirë zyrtarë të QPS-së, ndërsa nuk janë gjetur të dhëna që tregojnë pjesëmarrjen e MV-ve[12]. Nuk janë gjetur njoftime me shkrim që dëshmojnë se janë njoftuar MV-të apo QPS-të mbi këto raste. Sipas raporteve të DPBP-së, në vitin 2021, MV-të kanë ardhur në stacione për 1.316 raste të dhunës në familje nga 2.456 sosh (54%), në vitin 2022, ky numër ka rënë në 103 raste nga 2.764 të raportuara (3.7%), kurse në vitin 2023, ky numër ka shkuar në 224 raste nga 2.639 të raportuara (8.5%). Nga këta tregues

[10] Neni 16, paragrafi 1, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore (Përgjegjësitë e Mbrojtësit të Viktimave).

[11] Kapitulli XI, pika d, e Procedurës Standarde të Operimit për Parandalimin dhe Trajtimin e Dhunës në Familje.

[12] Sipas Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Mbrojtësi i viktimave është personi i autorizuar zyrtar, i cili ndihmon drejtpërdrejtë palën e dëmtuar që nga kontaktet e para me organet kompetente të mbrojtjes, këshillon, inicion procedurat për caktimin e masave të mbrojtjes, është i obliguar të marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, të monitorojë mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.

rezulton se në vitin 2021, kemi pasur mesatarisht 5.4 prezenca të MV-ve në çdo 10 raste të raportuara, në vitin 2022, diku 0.4 prezenca të tyre në çdo 10 raste, kurse në vitin 2023, diku 0.9 prezenca të tyre në çdo 10 raste. Shifrat e vitit 2022 dhe 2023 tregojnë prezencë të ulët në stacione policore të MV-ve. Sipas matjeve në nivel rajonal rezulton se në vitin 2023, numri i prezencave të MV-ve në raport me numrin e rasteve është më i lartë në DRP-Prishtinë që arrin në 2.5 prezenca në çdo 10 raste, derisa më i ulët është në DRP-Gjilan me 0 prezencë në çdo 10 raste.

Diagrami 6 - Prezenca në stacione e MV-ve në raport me numrin e rasteve (për çdo 10 raste)



3.7. Edhe QPS është akter me rëndësi në trajtimin dhe përkujdesjen ndaj viktimave të dhunës në familje, me përgjegjësi të ndara me Ligjin, PSO-në e Strategjinë. Me Ligj përcaktohet që ndër detyrat dhe përgjegjësitë e QPS-së është "intervenimi në secilin rast kur kontaktohet nga Policia e Kosovës", po ashtu "intervenimi sipas detyrës zyrtare, në secilin rast kur dyshohet se ka dhunë në familje dhe intervenimin në raste kur kontaktohen nga akterë në sistemin referues për mbrojtje nga dhuna ne familje"[13]. Zyrtarin e QPS-së, PSO e përkufizon si personin e autorizuar nga QPS si institucion publik i nivelit komunal, kompetent për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në ri-integrim të viktimës. Sipas PSO-së, është detyrë e hetuesit të dhunës në familje në nivel stacioni që të njoftojë zyrtarët e qendrës për punë sociale[14]. Sipas raporteve të DPBP-së, në vitin 2021, zyrtarët e QPS-së kanë dalur në stacione për 1.385 raste të dhunës në familje nga gjithsej 2.456 raste (56%), në vitin 2022, ky numër ka rënë në 911 raste nga 2.764 raste të raportuara (33%), derisa në vitin 2023, ky numër ka rënë në 862 raste nga 2.639 raste të raportuara (33%). Nga këta tregues rezulton se në vitin 2021, kemi pasur diku 5.6 dalje të zyrtarëve të QPS-së në çdo 10 raste të raportuara, në vitin 2022, diku 3.3 dalje të tyre në çdo 10 raste, njëjtë sikurse edhe në vitin 2023. Shifrat e viteve të fundit tregojnë një rënie të prezencës në stacione të zyrtarëve të QPS-së. Sipas matjeve në nivel rajonal rezulton se në vitin 2023, numri i daljeve të zyrtarëve të QPS-së në raport me numrin e rasteve është më i lartë në DRP-Prishtinë që arrin në kuotën 5.8 dalje në çdo 10 raste të raportuara, derisa më i ulët është në kuadër të DRP-Gjilan me një kuotë 0.3 dalje në çdo 10 raste të raportuara.

Diagrami 7 - Prezenca në stacione e zyrtarëve të QPS-së në raport me numrin e rasteve (për çdo 10 raste)

3.8. Me Ligj është përcaktuar që "Policia e Kosovës në momentin e identifikimit të viktimës së dhunës në familje ose dhunës ndaj grave duhet të ftojë për t'iu përgjigjur

[13] Neni 21, paragrafi1, pika1 dhe 2 të Ligjit nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore (Përgjegjësitë e Mbrojtësit të Viktimave).
[14] Kapitulli XI, pika d, e Procedurës Standarde të Operimit për Parandalimin dhe Trajtimin e Dhunës në Familje.

	rastit menjëherë Prokurorin e Shtetit, në rast se veprimet përbëjnë vepër penale sipas përkufizimeve të Kodit Penal, Qendrën për Punë Sociale ku ai person ka vendbanimin ose vendqëndrimin dhe mbrojtësin e viktimave, me qëllim të vlerësimit të rrezikut, nevojave të viktimës dhe njoftimit me të drejtat e viktimës"[15]. Në kuadër të kritereve për kontrollin e dosjeve është vlerësuar dhe prezenca e Raportit policor brenda dosjes hetimore, që i drejtohet Prokurorit kompetent për njoftim mbi dyshimin e arsyeshëm se është kryer vepra penale bazuar në dispozitën ligjore të KPP[16]. Nga dosjet hetimore të kontrolluara, në 14 nga 23 prej tyre është gjetur që kallëzimet penale së bashku me raportet policore janë proceduar tek Prokurori brenda 72 orëve, ndërsa në 9 nga 23 raste tjera nuk është hasur njoftimi me shkrim brenda këtij afati[17]. Vërehet se në një pjesë të rasteve, raportimi i dyshimit të arsyeshëm lidhur me veprën penale praktikohet si raportim verbal nga hetuesit për Prokurorin e Shtetit. 3.9. "Në fazën e veprimeve fillestare, Policia vlerëson rrezikun për viktimën e dhunës në familje në prani edhe të Mbrojtësit të viktimave[18]. Është detyrë e hetuesit të dhunës në familje që të plotësojë formën bazike të vlerësimit të rrezikut. Sipas PSO-së, hetuesi i dhunës në familje përpilon vlerësimin e rrezikut, bashkë me mbikëqyrësin e hetimeve apo mbikëqyrësin e ndërrimit me prezencë të MV-së dhe zyrtarit nga QPS-ja. Nga kjo kuptohet se gjatë vlerësimit të rrezikut, Policia duhet të përgatisë formën bazike të të dhënave për rastin. Inspektimi i dosjeve vë në pah se në rastet e kontrolluara është bërë vlerësimi mbi shkallën e rrezikut për viktimat, por në tre (3) prej tyre, ky vlerësim nuk është bërë sipas formës standarde të vlerësimit[19]. IPK-ja edhe në të kaluarën ka rekomanduar aplikimin e vlerësimit të rrezikut. 3.10. Policia luan rol me rëndësi në mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut[20]. Lidhur me këtë, IPK ka vlerësuar respektimin e të drejtave në procedurë paraprake, gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarve/dëshmitarëve. Deklaratat kanë përmbajtur të drejtat e personave të intervistuar dhe janë nënshkruar nga ta. Është gjetur që të drejtat e rezervuara me KPPK e të përfshira në procesverbalet e marrjes në pyetje të dëshmitarit/dyshuarit nuk janë harmonizuar me ndryshimet ligjore në fuqi (KPPK). Analiza e kryer mbi dosjet pasqyron se nevojitet kontroll i shtuar mbi hetuesit me qëllim të rritjes së kualitetit e të profesionalizmit gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Nevojitet që gjatë intervistimit të palëve të parashtrohet numër më i madh pyetjesh mbi rastin dhe që në konsultim me Prokurorin kompetent, të përfshihen dhe dëshmitarë tjerë potencial që mund t'i kontribuojnë zbardhjes së rastit. 3.11. Pakoja informuese për viktimat e krimit, e cila përmban Kartelën e viktimës me informata dhe këshilla mbi rastin, është obligative që nga viti 2020, që të jetë pjesë e rastit dhe dosjes. Sipas PSO-së, Kartela e viktimës është dokument me informacione bazike rreth rastit të lajmëruar, i cili i jepet viktimës pas inicimit të rastit[21]. Në dosjet e kontrolluara është gjetur që në 20 nga 23 prej tyre, viktimat janë pajisur me Pakon e

[15] Neni 19, paragrafi 6 i Ligjit.

[16] Neni 71, paragrafi 6 i KPP-së përcakton që "Posa policia të pranoj kërkesën për ndjekje penale nga pala e dëmtuar ose posa të njoftohet se një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare është kryer, tentuar, është duke u kryer apo do të kryhet së shpejti, policia është e detyruar që menjëherë të njoftojë prokurorin e shtetit dhe t'i dorëzojë raport policor brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve".

[17] Dragash (2024-GD-16), Mitrovicë Veriu (2024-SE-151), Shtime (2024-AU-112), Podujevë (2024-AF-079), Viti (2024-CG-095), Deçan (2024-DC-89, 2024-DC-156) dhe Skenderaj (2024-BF-229, 2024-BF-3).

[18] Vlerësimi i rrezikut është proces përmes të cilit vlerësohet niveli i rrezikut që i kanoset viktimës dhe personave tjerë, e cila është një formë unike që duhet plotësuar dhe bazuar në rrethanat e rastit, duke përfshirë deklaratat e dhëna në polici nga të gjitha palët, kërcënimin që e ndjen viktima, lëndimet, gjendjen emocionale, frika e viktimës, e kaluara kriminale e të dyshuarit, etj.

[19] Skenderaj (2024-BF-3), Podujevë (2024-AF-078) dhe Zveçan (2024-SG-5).

[20] Sipas nenit 122 të KPP-së, në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, hetuesi i autorizuar nga Prokurori i Shtetit, para marrjes në pyetje i lexon dëshmitarit apo të dyshuarit paralajmërimet mbi të drejtat e rezervuar nga ky Ligj dhe i njëjti duhet të konfirmoj me shkrim mbi të kuptuarit e të drejtave të lexuar nga hetuesi.

[21] Kapitulli III, pika v, e PSO-së për Parandalimin dhe Trajtimin e Dhunës në Familje.

viktimave, derisa në tre (3) sosh nuk është gjetur një e tillë[22]. Pajisja e viktimave me Kartelën e viktimës ka qenë rekomandim i dhënë në inspektimin e kaluar.

3.12. Sipas Ligjit, Policia përpilon Raport ditor lidhur me rastin, pavarësisht se a është kryer vepra penale dhe a është ndaluar dikush dhe një kopje të këtij Raporti ia dorëzon viktimës, përfaqësuesit të saj ligjor, mbrojtësit të viktimës dhe Qendrës për Punë Sociale[23]. Sipas PSO-së, Raporti ditor përpilohet nga hetuesi i dhunës në familje, me këtë Raport njoftohet dhe Mbikëqyrësi rajonal i dhunës në familje dhe Sektori qendror. Nga kontrolli i dosjeve ka rezultuar se në 20 nga 23 sosh është evidentuar prezenca e Raportit ditor të dhunës në familje, derisa në 3 sosh nuk është gjetur një raport i tillë[24]. Duhet potencuar se edhe herën e kaluar, IPK ka rekomanduar përpilimin e raporteve.

3.13. Sipas PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit, kallëzimet penale duhet që para procedimit të nënshkruhen nga Hetuesi, Mbikëqyrësi i vijës së parë në Sektorin e Hetimeve (rreshteri) dhe Shefi i hetimeve. Kallëzimet penale vetëm në Dragash janë aprovuar sipas rregullit të paraparë me PSO. Në Lipjan, Novobërdë, Skenderaj, Deçan, Viti, Podujevë, Suharekë, Zveçan, Shtime, Shtërpce dhe Mitrovicë Veriu, kallëzimet penale nuk janë nënshkruar sipas rregullit të lartcekur, duke mos e marrë aprovimin e plotë sipas zinxhirit komandues.

3.14. Stacionet policore konform nenit 81 të KPP-së kanë ngritur kallëzime penale kundër të dyshuarve për veprën penale "Dhunë në familje". Të dhënat lidhur me rastet e marra mostër janë dorëzuar në Prokurori bashkë me procesverbalet, raportet dhe format bazike të të dhënave të rastit. Lëndët si mostra janë proceduar në Prokuroritë kompetente përmes SMIL dhe fizikisht. Vërehet se gjatë hartimit të kallëzimit penal nevojitet kujdes i shtuar në vendosjen e saktë të të dhënave të mbledhura përmes veprimeve hetimore, të tregohet se ndaj kujt ngritet kallëzimi penal, të pasqyrohen të dhënat mbi të dëmtuarit a viktimat, dhe të arsyetohet saktë ngritja e kallëzimit penal mbështetur në fakte të mbledhura. Procedimi i kallëzimeve penale nga Policia është bërë brenda afatit prej 30 ditësh, nga veprimi i fundit hetimor në të gjitha dosjet e kontrolluara[25]. Është matur po ashtu edhe koha mesatare e procedimit të kallëzimeve penale në Prokurori, ku rezulton që rastet e marra mostër mesatarisht janë proceduar për 6.7 ditë.

3.15. Pas analizës së dosjeve, IPK ka vlerësuar dhe veprimet e Policisë në ekzekutimin e Urdhrave për mbrojtje të nxjerrë për viktimat e dhunës në familje[26]. Bazuar në dosjet e kontrolluara është parë që në rastet kur ka qenë e nevojshme ndërmarrja e veprimeve me qëllim të zbatimit të tyre, Policia ka bashkëpunuar ngushtë duke u ofruar ndihmën e nevojshme viktimave, me qëllim të ofrimit të sigurisë. Në dosje janë gjetur evidenca për ekzekutimin e masave mbrojtëse, që tregojnë për kontakte dhe vizita që Policia u ka bërë viktimave të rasteve të dhunës në familje në rastet kur është parë e nevojshme, apo është kërkuar nga ana e viktimës, palës së mbrojtur.

3.16. Policia ka të hartuar formularët e nevojshëm të punës, të harmonizuar me aktet ligjore në fuqi dhe të njëjtit iu shërbejnë zyrtarëve policorë gjatë kryerjes së veprimeve hetimore. Gjatë analizimit të dosjeve hetimore është vërejtur se formularët e përdorur brenda dosjeve janë unik dhe ka një standard të caktuar të hartimit të tyre.

---

[22] Deçan (2024-DC-89, 2024-DC-156) dhe Podujevë (2024-AF-078).

[23] Neni 19, paragrafi 5 i Ligjit nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore (Përgjegjësitë e Mbrojtësit të Viktimave).

[24] Deçan (2024-DC-89, 2024-DC-156), Suharekë (2024-GB-98) dhe Podujevë (2024-AF-078).

[25] Kodi i Procedurës Penale, neni 82, paragrafi 5 "Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se një vepër penale është kryer, policia i dorëzon kallëzim penal brenda tridhjetë (30) ditëve pas veprimit të fundit të ndërmarr nga policia, prokurorit kompetent të shtetit i cili vendos nëse do të iniciojë procedurën penale".

[26] 2021-AJ-0441, 2022-AJ-400, 2021-AJ-0238, 2022-AJ-0406 dhe 2022-AJ-0292.

Përfundime	**1. Trendët e krimit dhe ekspozimi** 1.1. Me gjithë faktin se në të kaluarën, trendet mbi numrin e rasteve të dhunës në familje kanë qenë në rritje, në vitin e fundit ka trend rënës të zhvillimit të këtij krimi në masën prej -4.5%. 1.2. Marrë parasysh numrin e rasteve në raport numrin e banorëve dhe me shtrirjen gjeografike, zonat e përgjegjësisë që kontrollojnë Fushë Kosova, Mitrovicë Veriu, Graçanica dhe Shtërpca dalin të jenë më të ekspozuarat ndaj këtij krimi. 1.3. Stacionet policore me ngritjen më të theksuar të numrit të rasteve në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, dalin të jenë Novobërda, Shtërpca, Obiliqi, Mitrovicë Veriu, Istogu dhe Prizreni. **2. Baza ligjore, organizimi dhe kapacitetet:** 2.1. Policia ka para vetes rregullativë të nevojshme për të mbështetur përmbushjen e mandatit në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje, e cila buron nga kërkesat e Konventës së Stambollit. 2.2. Sa i përket burimeve njerëzore nëpër ekipe, jo të gjitha stacionet përmbushin numrin e paraparë me Strukturë, meqë ka mungesë, apo tejkalim të numrit të personelit, por edhe mungesë të gradës së rreshterit për mbikëqyrje në ekipe. 2.3. Zyrtarët policor në stacionet e inspektuara policore që trajtojnë rastet e dhunës në familje janë të përgatitur falë programeve trajnuese dhe të certifikuar. 2.4. Obligimi mbi funksionalizimin e "dhomave mike" për intervista dhe trajtim të viktimave është përmbushur në masën 83% për stacionet e inspektuara. **3. Veprimet hetimore gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje:** 3.1. Stacionet vazhdojnë të kenë kohë të reagimit në rastet e dhunës në familje që variron nga njëra tek tjetra dhe përgjithësisht është regjistruar një kohë më e shpejtë krahasuar me vitin e kaluar. Tek stacionet që kanë pasur reagim më të shtyrë duket të ketë ndikuar dhe shtrirja gjeografike e terrenit që mbulojnë ato. 3.2. Viktimat e dhunës në familje kanë shfrytëzuar të drejtën për ndihmë mjekësore dhe në vitin e fundit ka pasur një ngritje të përqindjes së vizitave mjekësore në raport me numrin e viktimave. 3.3. Në rastet kur ka pasur dyshime se kryesit e dhunës në familje mund të kenë qenë nën ndikimin e alkoolit, atyre iu është matur prezenca e alkoolit në gjak me anë të alkool testeve. Këto pajisje janë hasur funksionale dhe të kalibruara. 3.4. Numri i të ndaluarve në raport me numrin e rasteve pasqyron një trend të njëjtë me atë të vitit paraprak. Pasqyrohen së paku dy rajone, ku përqindjet e tyre reflektojnë vlera të dallueshme periferike se sa mesatarja). 3.5. Prezenca në stacione e mbrojtësve të viktimave dhe zyrtarëve të qendrave për punë sociale nuk është e mjaftueshme, ngase viteve të fundit ajo është e ulët krahasuar me vitet e kaluara. 3.6. Komunikimi me Prokurorin e Shtetit po vazhdon të preferohet përmes telefoni. Kjo mënyrë raportimi nuk duhet të përjashtoj raportimin me shkrim, i cili ka filluar të praktikohet kohëve të fundit. Janë hasur dosje që nuk kanë Raport njoftues lidhur me dyshimin e arsyeshëm se është kryer vepra penale. 3.7. Vlerësimi i rrezikut për viktimat edhe pse është realizuar në të gjitha rastet, në disa prej tyre nuk është kryer sipas formës standarde të paraparë, që përmban indikatorët mbi të cilët kryhet vlerësimi. 3.8. Palëve iu janë respektuar të drejtat në procedurën paraprake, gjatë marrjes në pyetje. Deklaratat kanë përmbajtur të drejtat e personave të intervistuar dhe janë nënshkruar nga palët. Intervistat duhet të jenë edhe më përmbajtësore dhe në konsultim me Prokurorin, të përfshijnë dhe dëshmitarë tjerë potencial.

	3.9. Pako informuese që përmban Kartelën e viktimës nuk iu është dhënë viktimave në të gjitha rastet e dhunës në familje. 3.10. Raporti ditor i rastit, që duhet të përpilohet nga hetuesi i dhunës në familje, me të cilin njoftohet mbikëqyrësi rajonal i dhunës në familje dhe sektori qendror, edhe pse është hasur në pjesën dërmuese të dosjeve, mungon në disa prej tyre. 3.11. Në një numër të konsideruar të dosjeve që lidhen me një sërë stacionesh janë hasur lëshime në procedimin e rasteve, meqë nuk është respektuar në masën e duhur, kriteri i aprovimit në respektim të zinxhirit komandues. 3.12. Të gjitha lëndët e kontrolluara janë proceduar në Prokurori të Shtetit përmes SMIL-it. 3.13. Kallëzimet penale janë proceduar në kohë të shkurtër dhe brenda afateve. Sa i përket cilësisë, duhet kujdesur që ato të avancohen në përmbajtje. 3.14. Nuk janë evidentuar mosveprime në përmbushje të obligimeve nga stacionet në monitorimin e ekzekutimit të urdhrave mbrojtës. Ka evidenca të shkruara mbi vizitat dhe kontaktet e Policisë me viktimat e dhunës në familje.

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	**Rekomandimi**	**Niveli i prioritetit**	**Komentet e strukturës policore[27] (në origjinal)**	**Plani i veprimit**
1.	*IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore të inspektuara, që në koordinim me Drejtoritë Rajonale dhe Drejtorinë e Personelit, të ndërmarrin veprime për të funksionalizuar ekipet e hetimit të dhunës në familje, si dhe të përmbushin të njëjtat me burimet e nevojshme njerëzore konform Strukturës organizative dhe Listës së Personelit të Autorizuar.*	*-I-*	*Drejtori i Departamentit të Rendit Publik duke pas parasysh mungesat e tilla, në Strukturën e re Organizative ka paraparë personel të mjaftueshëm nëpër Stacionet Policore për rastet e tilla. Gjithashtu propozimet për plotësimin e personelit në këtë fushë janë dhënë me kohë. Ky rekomandim pritet të përmbushet në periudhën kohore K-2 2025.*	*K-2 2025*
2.	*IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore në Novo Bërdë dhe Dragash, shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve, që të mobilizohen në ushtrimin e kontrolleve mbi njësitë policore, për të siguruar kohë efektive të reagimit në thirrje të qytetarëve për dhunë në familje.*	*-I-*	*Drejtori i Departamentit të Rendit Publik urdhëron Drejtorët Rajonal të ketë mbikëqyrje të shtuar tek Komandantët e Stacioneve Policore të theksuara në Rekomandim, në mënyrë që në periudhën K-4 2024 të përpilohet një raport përmbledhës lidhje me rekomandimin e dhënë dhe përmirësimet e arritura. Në fund të periudhës K-4 raporti përmbledhës të dërgohet në Divizionin e Policimit në Bashkësi/Drejtoria e parandalimit dhe hetimit të Dhunës në Familje.*	*Në vazhdimësi kontroll dhe mbikëqyrje*
3.	*IPK-ja u rekomandon shefave të sektorëve të hetimeve dhe mbikëqyrësve të ekipeve të hetimeve, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit që trajtojnë rastet e dhunës në familje, për t'u siguruar se Mbrojtësit e Viktimave njoftohen edhe me shkrim lidhur me rastet, për të qenë në funksion të viktimave të dhunës në familje.*	*-I-*	*Drejtori i Departamentit të Rendit Publik urdhëron Drejtorët Rajonal të ketë mbikëqyrje të shtuar tek Komandantët e Stacioneve në mënyrë që në periudhën K-4 2024 të përpilohet një raport përmbledhës lidhje me rekomandimin e dhënë dhe përmirësimet e arritura. Në fund të periudhës K-4 raporti përmbledhës të dërgohet në Divizionin e Policimit në Bashkësi/Drejtoria e parandalimit dhe hetimit të Dhunës në Familje.*	*Në vazhdimësi kontroll dhe mbikëqyrje*
4.	*IPK-ja u rekomandon shefave të sektorëve të hetimeve në kuadër të stacioneve policore, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit e dhunës në familje, për t'u siguruar që gjatë intervistimit të palëve, u parashtrohet numër më i madh*	*-I-*	*Drejtori i Departamentit të Rendit Publik urdhëron Drejtorët Rajonal të ketë mbikëqyrje të shtuar tek Komandantët e Stacioneve në mënyrë që në periudhën K-4 2024 të përpilohet*	*Në vazhdimësi kontroll dhe mbikëqyrje*

[27] Komentet e strukturës policore janë përmbajtje e tekstit autentik të saj dhe në to nuk ka pasur ndërhyrje. Komentet janë pranuar me shkrim pas takimit përmbyllës të datës 28.10.2024, të realizuar nga përfaqësues të Departamentit të Inspektimit të IPK-së dhe strukturës policore të inspektuar.

	pyetjesh lidhur me rastet dhe që në konsultim me Prokurorin kompetent, intervistat të përfshijnë edhe dëshmitarë tjerë potencial që mund t'i kontribuojnë zbardhjes së rastit.		*një raport përmbledhës lidhje me rekomandimin e dhën dhe përmirësimet e arritura. Në fund të periudhës K-4 raporti përmbledhës të dërgohet në Divizionin e Policimit në Bashkësi/Drejtoria e parandalimit dhe hetimit të Dhunës në Familje.*	
5.	*IPK-ja u rekomandon shefave të sektorëve të hetimeve të stacioneve (Podujevë, Suharekë dhe Deçan), që të ushtrojnë kontrolle mbi hetuesit e dhunës në familje, për t'u siguruar se në të gjitha rastet kur ka dhunë në familje, përpilohet Raport ditor lidhur me rastin dhe një kopje e tij i dërgohet mbikëqyrësit rajonal të dhunës në familje dhe sektorit qendror.*	*-I-*	*Drejtori i Departamentit të Rendit Publik urdhëron Drejtorët Rajonal të ketë mbikëqyrje të shtuar tek Komandantët e Stacioneve në mënyrë që në periudhën K-4 2024 të përpilohet një raport përmbledhës lidhje me rekomandimin e dhënë dhe përmirësimet e arritura. Në fund të periudhës K-4 raporti përmbledhës të dërgohet në Divizionin e Policimit në Bashkësi/Drejtoria e parandalimit dhe hetimit të Dhunës në Familje.*	*Në vazhdimësi kontroll dhe mbikëqyrje*
6.	*IPK-ja u rekomandon shefave të sektorëve të hetimeve të stacioneve policore (Lipjan, Novo Bërdë, Skenderaj, Deçan, Viti, Podujevë, Suharekë, Zveçan, Shtime, Shtërpce dhe Mitrovicë Veriu), që gjatë ushtrimit të kontrollit mbi lëndët, të ndiqet procedura e aprovimit sipas zinxhirit komandues dhe fillimisht ato të aprovohen nga hetuesit e lëndëve, mbikëqyrësi i vijës së parë dhe më pas nga Shefi i Sektorit të Hetimeve, konform Procedurës Standarde të Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit.*	*-I-*	*Drejtori i Departamentit të Rendit Publik urdhëron Drejtorët Rajonal të ketë mbikëqyrje të shtuar tek Komandantët e Stacioneve në mënyrë që në periudhën K-4 2024 të përpilohet një raport përmbledhës lidhje me rekomandimin e dhënë dhe përmirësimet e arritura. Në fund të periudhës K-1 raporti përmbledhës të dërgohet në Divizionin e Policimit në Bashkësi/Drejtoria e parandalimit dhe hetimit të Dhunës në Familje.*	*Në vazhdimësi kontroll dhe mbikëqyrje*

Shtojca

Shtojca 1 - Indikatorët e shtrirjes së dhunës në familje për 1.000 banorë dhe për 1 km² (2023)			
Zona e përgjegjësisë	**Numri i rasteve**	**Raste në 1.000 banorë[28]**	**Raste për 1 km²**
Prishtinë	415	1.89	0.79
Podujevë	87	1.08	0.14
Lipjan	65	1.13	0.19
Fushë Kosovë	140	3.57	1.69
Obiliç	46	2.66	0.44
Graçanicë	43	3.54	0.33
Drenas	62	1.02	0.21
Prizren	273	1.41	0.44
Suharekë	64	1.14	0.18
Dragash	12	0.36	0.03
Mamushë	1	0.17	0.09
Ferizaj	151	1.43	0.44
Kaçanik	28	0.81	0.13
Shtime	26	0.96	0.19
Shtërpce	20	3.08	0.08
Hani i Elezit	4	0.4	0.05
Mitrovicë Jugu	107	1.57	0.32
Vushtrri	74	1.21	0.21
Skënderaj	53	1.01	0.14
Gjakovë	154	1.66	0.26
Rahovec	48	0.87	0.17
Malishevë	66	1.18	0.18
Pejë	217	2.23	0.36
Istog	56	1.36	0.12
Klinë	34	0.85	0.11
Deçan	31	0.73	0.17
Junik	6	0.94	0.07
Gjilan	173	2.35	0.44
Kamenicë	13	0.5	0.03
Viti	52	1.1	0.19
Novo Bërdë	13	1.84	0.06
Partesh	4	2.39	0.22
Kllokot	8	2.96	0.33
Ranillug	3	0.81	0.04
Mitrovicë Veriu	40	3.37	3.64
Zveçan	2	0.28	0.02
Leposaviq	12	0.93	0.02
Zubin Potok	1	0.15	0.01
38 komuna/stacione	**2.604**	**1.47**	**0.24**
DRP-të	**35**		
Gjithsej	**2.639**	**1.49**	**0.24**

[28] Gjatë analizës së shpërndarjes së rasteve të dhunës në familje për 1.000 banorë, është marrë për bazë numri i popullsisë së vendit sipas vlerësimit të ASK, që për vitin 2022 është 1.773.971 banorë.

Shtojca 2 - Përmbledhje aktivitetesh policore në trajtimin e dhunës në familje (2022/2023)								
Drejtoria Rajonale	**Ndalim policor për 48 orë**		**Ndihmë mjekësore**		**Dalje të Zyrtarit të QPS**		**Dalje të MV në stacion**	
	2022	**2023**	**2022**	**2023**	**2022**	**2023**	**2022**	**2023**
Prishtinë	369	352	466	478	437	502	0	215
Gjilan	96	80	106	87	16	7	12	0
Ferizaj	113	97	97	101	63	33	1	1
Gjakovë	176	153	166	138	105	94	6	1
Pejë	108	103	96	107	94	86	23	1
Prizren	151	165	134	179	72	53	2	2
Mitrovicë Jugu	48	65	78	79	96	73	38	1
Mitrovicë Veriu	23	22	18	23	28	14	21	3
Gjithsej	**1.084**	**1.037**	**1.161**	**1.192**	**911**	**862**	**103**	**224**